



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.  
Tiranë, datë \_\_\_/\_\_\_/2023.

**RELACION**

**MBI HARTIMIN E PROGRAMIT EKONOMIK DHE FINANCIAR TË VEPRIMTARISË SË  
ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE PËR VITIN 2024.**

Drejtoria e Përgjithshme me shkresën Nr. 1926, datë 10.11.2023 “Mbi hartimin e programit ekonomik dhe financiar të vitit 2024”, ka dhënë udhëzime për Degët Rajonale dhe Drejtoritë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të EKB-së, për përgatitjen e programit ekonomik dhe financiar, të treguesve kryesor të të ardhurave, shpenzimeve të veprimtarisë, investimeve ndërtimore dhe jo ndërtimore, si dhe për çështje të tjera për aktivitetin e vitit 2024.

Në mbështetje të Ligjit Nr.7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, i ndryshuar, VKM Nr. 198, datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave“, i ndryshuar, si dhe Statutin e EKB-së nr. 325/2 prot, datë 25.02.2019, gjatë muajit nëntor-dhjetor 2023, Degët Rajonale të EKB-së dhe Drejtoritë pranë Drejtorisë së Përgjithshme kanë punuar për përgatitjen e projekt-programit ekonomik dhe financiar për vitin 2024.

Për këtë, programi ekonomik i vitit 2024 është hartuar në bazë të trendit dhe eksperiencës të viteve të mëparshme për planifikimin e shpenzimeve të veprimtarisë. Të ardhurat janë parashikuar mbi bazën e produktit të gatshëm (apartamente, njësi shërbimi dhe garazhe) në dispozicion për të shitur, si në banesat e reja ashtu edhe banesat për privatizim, si dhe përdorimin me efektivitet të burimeve ekzistuese të Entit. Konkretisht të ardhurat e vitit 2024 përfshijnë:

- Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara ndër vite nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit dhe donatorëve të ndryshëm.
- Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së.
- Të ardhurat nga interesat për kontratat e lidhura ndër vite nga Degët Rajonale të EKB-së.
- Të ardhurat nga shitja e njësisve të shërbimit dhe garazheve në banesat e ndërtuara me fondet e veta të EKB-së.

- Të ardhurat nga privatizimet e njësive të banimit të objekteve me VKM, si dhe privatizimi i objekteve të Ministrisë së Mbrojtjes të kthyer në fond banese.
- Të ardhurat nga 4% (pagesa e shpenzimeve operacionale për EKB-në), të llogaritur për kontratat e reja të apartamenteve dhe njësive të banimit të objekteve me VKM.
- Të ardhurat nga interesat e depozitave bankare, për fondet e lira gjendje në bankat e nivelit të dytë të Drejtorisë së Përgjithshme.
- Të ardhura të tjera, ku përfshihen të ardhurat nga biletat e parkut të automjeteve, të ardhurat nga gjobat dhe penaltetet, etj.

Në përfundim të punës së kryer nga Degët Rajonale të EKB-së për hartimin e këtij projekt-programi, janë përgatitur dhe pasqyruar treguesit kryesor ekonomik dhe financiar të cilët janë rishikuar nga Drejtoria e Përgjithshme, për të bërë të mundur maksimalizimin e të ardhurave dhe përdorimin me efikasitet të shpenzimeve për vitin 2024.

Projekt-programi ekonomik dhe financiar i EKB-së që paraqesim Këshillit Drejtues, trajton çështjet kryesore si vijon:

- I. Objektivat e programit ekonomik dhe financiar.
- II. Planifikimi i treguesve ekonomik dhe financiar të veprimtarisë.
- III. Planifikim dhe detajimi i planit të investimeve ndërtimore.
- IV. Planifikimi i aktiviteteve mbështetëse.

## I. Objektivat e Programit Ekonomik dhe Financiar.

Enti Kombëtar i Banesave në këtë projekt-program ka parashikuar burimet për sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për vazhdimimin e veprimtarisë së tij, në planifikimin e investimeve të reja si dhe vazhdimin e ndërtimeve të nisura gjatë vitit 2023 dhe para tij.

Në varësi të programimit të treguesve kryesor, janë përcaktuar objektivat e Entit Kombëtar të Banesave për vitin 2024, të cilat i paraqiten Këshillit Drejtues për miratim, së bashku me programin ekonomik-financiar, si më poshtë:

- 1- Të realizojë të ardhurat në shumën **199,586,000 lekë** gjatë aktivitetit ekonomik dhe financiar dhe të mbajë nën kontroll shpenzimet e veprimtarisë për **136,000,000 lekë**. (ose **146,694,000 lekë** me parashikimin e rritjes së pagave)
- 2- Të realizojë një rezultat financiar (fitim bruto) në shumën **63,586,000 lekë** (ose **52,892,000 lekë** me parashikimin e rritjes së pagave)
- 3- Në fushën e investimeve, objektivi i vitit 2024 do të jetë:

\*Përfundimi i banesave të nisur nga viti 2021, 2022 dhe 2023 në qytetet Vlorë, Has, Tropojë, Burrel, Delvinë dhe Roskovec,.

\*Fillimi i ndërtimit të banesave të reja për të pastrehët në qytetet Shijak, Tropojë, Shkodër, Korçë, Lushnje, Burrel, Peshkopi.

- 4- Të realizohet gjatë vitit, strehimi i 362 familjeve, nëpërmjet shitjes së apartamenteve të banesave të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së dhe me fondet e buxhetit të shtetit.
- 5- Të bëhet e mundur shitja e 32 njësive të shërbimit dhe 52 garazheve të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nëpërmjet ankandeve të njësive të shërbimit dhe garazheve, nga të cilat: 3 njësi shërbimi në Fier, 12 garazhe në Gramsh, 3 garazhe në Korçë, 8 garazhe në Maliq, 11 garazhe dhe 9 njësi në Vlorë, 7 njësi shërbimi në Tropojë, 9 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Has, 9 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Burrel, Të ulet numri i klientëve debitorë në nivelin 15 % ose 90 debitorë të trashëguar nga gjëndja vitit 2023.

## **II. Programimi i Treguesve Ekonomik dhe Financiar të Veprimtarisë.**

### **A. Planifikimi i të Ardhurave**

Burimet kryesore të të ardhurave financiare për vitin 2024 për Degët Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të EKB-së do të jenë si më poshtë:

- a) Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara ndër vite nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit dhe donatorëve të ndryshëm
- b) Të ardhurat nga shitja e apartamenteve të banesave të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së në Vlorë, Has, Tropojë, Burrel dhe Delvinë
- c) Të ardhurat nga 4%, ku përfshihen pagesa e shpenzimeve operacionale për EKB-në sipas vlerave të kontratave të reja të programuara për shitjen e apartamenteve dhe njësive të banimit të ndërtuara me fondet e EKB si dhe privatizimi i objekteve me VKM.
- d) Të ardhurat nga shitja e njësive të banimit të objekteve të privatizuara me VKM dhe lidhja e kontratave të reja nga Degët Rajonale në Tiranë dhe Durrës.
- e) Të ardhurat nga shitja e njësive të shërbimit dhe garazhet në Fier, Korçë, Maliq, Kukës, Vlorë, Has, Tropojë dhe Burrel.
- f) Të ardhurat nga interesat e kontratave të lidhura ndër vite dhe nga ato që do të lidhen gjatë vitit 2024.
- g) Të ardhurat nga interesat e depozitave bankare për fondet e lira të EKB-së.
- h) Të ardhura të tjera ku përfshihen, të ardhurat nga parkimi i mjeteve të të tretëve, të ardhurat nga qiratë, gjobat e penalitetet, etj.

Programi i të ardhurave sipas zërave kryesor, për Degët Rajonale të EKB-së dhe për Drejtorinë e Përgjithshme paraqitet si më poshtë:


**PROGRAMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2024**

000 Lekë

| NR | Emertimi            | Te ardhura<br>neto nga<br>shitja dhe<br>privatizimi | Te ardhura<br>nga 4 % | Të ardhura<br>nga<br>Interesat e<br>kredive | Të ardhura<br>Interesa<br>depozita<br>dhe<br>bankare | Të<br>ardhura te<br>tjera | <b>TOTALI<br/>Plani<br/>2024</b> | I pritshmi<br>2023 | Plani 2023         |
|----|---------------------|---|-----------------------|---|--|---------------------------|----------------------------------|--------------------|--------------------|
| 1  | <b>TIRANE</b>       | 17,790,000  | 711,600               | 5,007,900                                   | 27,600   | 636,300                   | <b>24,173,400</b>                | 29,000,000         | 24,316,100         |
| 2  | <b>FIER</b>         | 979,600   | 92,000                | 4,165,800                                   |  | 55,000                    | <b>5,292,400</b>                 | 5,046,448          | 5,836,400          |
| 3  | <b>DURRES</b>       | 44,554,800  | 2,220,400             | 5,663,800                                   | 10,000   | 110,000                   | <b>52,559,000</b>                | 60,000,000         | 58,710,000         |
| 4  | <b>BERAT</b>        | -   |                       | 1,623,500                                   |  | 99,000                    | <b>1,722,500</b>                 | 2,132,879          | 1,766,900          |
| 5  | <b>KORCE</b>        | 889,300   | 20,000                | 7,004,000                                   | 4,800  | 113,700                   | <b>8,031,800</b>                 | 8,857,925          | 7,939,000          |
| 6  | <b>GJIROKASTER</b>  | 1,476,000   | 3,316,000             | 1,100,000                                   |  | 52,700                    | <b>5,944,700</b>                 | 1,599,273          | 1,484,200          |
| 7  | <b>SHKODER</b>      | 3,542,300   | 51,000                | 3,550,000                                   |  | 130,000                   | <b>7,273,300</b>                 | 18,502,560         | 4,691,800          |
| 8  | <b>ELBASAN</b>      | 2,775,500   |                       | 4,250,000                                   | 10,000   | 150,000                   | <b>7,185,500</b>                 | 16,160,183         | 6,478,000          |
| 9  | <b>VLORE</b>        | 16,751,500  | 14,392,900            | 2,100,000                                   | 1,000  | 100,000                   | <b>33,345,400</b>                | 6,236,568          | 24,320,500         |
| 10 | <b>KUKES</b>        | 7,950,000   | 7,054,000             | 7,200,000                                   |  | 60,000                    | <b>22,264,000</b>                | 9,130,990          | 22,643,200         |
| 11 | <b>DIBER</b>        | 6,572,000   | 2,700,000             | 2,099,000                                   | 2,000  | 132,000                   | <b>11,505,000</b>                | 1,253,030          | 5,265,000          |
| 12 | <b>LEZHE</b>        | 80,000  | 124,000               | 1,600,000                                   |  | 1,185,000                 | <b>2,989,000</b>                 | 2,963,772          | 2,950,900          |
| 13 | <b>Dr. PERGJITH</b> | -   |                       |   | 13,800,000   | 3,500,000                 | <b>17,300,000</b>                | 15,000,000         | 13,270,000         |
|    | <b>TOTALI</b>       | <b>103,361,000</b>                                  | <b>30,681,900</b>     | <b>45,364,000</b>                           | <b>13,855,400</b>                                    | <b>6,323,700</b>          | <b>199,586,000</b>               | <b>180,380,500</b> | <b>179,672,000</b> |

## PROGRAMI I TE ARDHURAVE SIPAS ZERAVE PER VITIN 2024

- Te ardhura neto nga shitja dhe privatizimi
- Te ardhura nga 4 %
- Të ardhura nga Interesat e kredive
- Të ardhura Interesa depozita dhe bankare
- Të ardhura te tjera



Siç del nga pasqyra e mësipërme, në planin e të ardhurave për vitin 2024, të ardhurat nga shitja dhe privatizimi (apartamente + njësi shërbimi + garazhe) zënë 51% të të ardhurave në total. Të ardhurat nga 4% për shpenzimet operationale zenë 16%, të ardhurat nga interesat e kontratave 23%, të ardhurat nga interesat e depozitave bankare 7%, dhe të ardhurat e tjera 3%.

Më hollësisht programi i treguesve kryesor të të ardhurave nga shitja paraqiten si më poshtë:

### **Planifikimi i të Ardhurave nga Shitja e Apartamenteve**

Gjatë vitit 2024 parashikohen të ardhura neto nga shitja rreth 90,000 mijë lekë, nga lidhja e rreth 362 kontrata të reja me fondet e veta të EKB-së, nga të cilat, Vlorë(1+2) 75 ap., Vlorë(3+4) 75 ap, Has 35, Tropojë 25, Shkodër 10, Dibër 26, Gjirokastra 29 dhe Lezhë 2, dhe me fonde te buxhetit te shtetit, Tirana 33 dhe Durrësi 47, Korca 4.

### **Planifikimi i të Ardhurave nga Shitja e njësive të shërbimit dhe garazheve**

Gjatë vitit 2024 janë planifikuar të shiten njësitë e shërbimit dhe garazhet për të cilat janë parashikuar shitja e 32 njësive të shërbimit dhe 52 garazheve të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nëpërmjet ankandeve të njësive të shërbimit dhe garazheve, nga të cilat: 3 njësi shërbimi në Fier, 1 njësi shërbimi (Librazhd), 12 garazhe në Gramsh, 3 garazhe në Korçë, 8 garazhe në Maliq, 11 garazhe dhe dhe 9

njësi në Vlorë, 7 njësi shërbimi në Tropojë, 9 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Has, 9 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Burrel, që së bashku zenë shumën e të ardhurave neto rreth 11,000 mijë lekë.

### **Të Ardhura nga Interesat e Kontratave të Lidhura**

Gjatë vitit 2024, janë planifikuar të realizohen të ardhura nga interesat e kontratave të lidhura të klientëve që kanë përfituar apartamente, të ndërtuara nga EKB me fondet e Buxhetit të Shtetit, Bankës Botërore dhe donatorë të tjerë.

Të ardhurat nga interesat e kontratave të lidhura për këto apartamente, programohen në shumën prej **45,364 mijë** lekë.

### **Të Ardhurat nga 4% i Shpenzimeve Operacionale**

Për vitin 2024 janë planifikuar të realizohen të ardhura nga 4% (shpenzime operacionale të EKB-së) nga shitja e apartamenteve të reja (Vlorë, Has, Tropojë, Delvinë dhe Burrel) si dhe apartamente të tjera të ndërtuara ndër vite me fondet e Buxhetit të Shtetit, si dhe nga privatizimet e njësisve të banimit të objekteve me VKM.

Për këtë vit janë programuar gjithësejt në shumën 32,682 mijë lekë, nga e cila për shitjet e apartamenteve në shumën 30,682 mijë lekë, dhe nga privatizimet e njësisve të banimit të objekteve me VKM në shumën 2,000 mijë lekë.

### **Të Ardhurat nga Interesat e Depozitave Bankare**

Mbështetur në gjendjen e depozitave dhe mirëmenaxhimin e fondeve të lira monetare të Drejtorisë së Përgjithshme, për vitin 2024 janë planifikuar interesat nga depozitat bankare me afat maturimi një vjeçar dhe 6/mujor si dhe interesa të tjera bankare në shumën **13,800 mijë** lekë.


### **Të Ardhura të Tjera.**

Këtu përfshihen të ardhurat e programuara nga shitja e biletave për parkimet e automjeteve në shumën **3,500 mijë** lekë, si dhe të ardhurat nga kamatë-vonesat, penalitetet dhe të tjera në shumën **2,823 mijë** lekë.

Programimi i të ardhurave të vitit 2024 sipas zërave kryesor krahasuar me pese vite paraardhëse (Plan-Fakt) paraqiten si vijon:

000 leke

| NR |                            | 2019           |                | 2020           |                | 2021           |                | 2022           |                | 2023           |                | Plan           |
|----|----------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
|    |                            | Plan           | Fakt           | Plan           | Fakt           | Plan           | Fakt           | Plan           | Fakt           | Plan           | I pritsh.      | 2024           |
| 1  | Të ardhurat nga shitja     | 46,886         | 36,164         | 49,230         | 25,862         | 39,477         | 29,375         | 40,731         | 52,790         | 27,139         | 22,834         | 38,561         |
| 2  | Të ardhura nga 4%          | 12,172         | 10,112         | 3,915          | 5,486          | 17,001         | 6,027          | 24,856         | 14,975         | 21,198         | 5,918          | 30,681         |
| 3  | Privatizimet me VKM        | 33,023         | 38,217         | 38,225         | 38,268         | 42,718         | 40,986         | 43,185         | 40,933         | 69,512         | 88,058         | 64,800         |
| 4  | Nga interesat e kontratave | 37,370         | 39,990         | 39,237         | 41,683         | 37,899         | 40,723         | 41,490         | 94,546         | 45,986         | 46,046         | 45,364         |
| 5  | Interesat depozitave       | 17,000         | 16,751         | 17,030         | 18,465         | 9,250          | 11,009         | 6,106          | 6,426          | 9,289          | 11,347         | 13,855         |
| 6  | Të ardhura të tjera        | 4,723          | 14,067         | 7,261          | 9,597          | 7,753          | 20,630         | 6,718          | 8,404          | 6,545          | 6,174          | 6,323          |
|    | <b>TOTALI</b>              | <b>151,176</b> | <b>155,304</b> | <b>154,900</b> | <b>139,362</b> | <b>154,100</b> | <b>148,752</b> | <b>163,086</b> | <b>218,077</b> | <b>179,672</b> | <b>180,380</b> | <b>199,586</b> |



Siç del edhe nga të dhënat e tabelës si më sipër, rezulton se planifikimi i të ardhurave për vitin 2024 parashikohet në masën 11% më shumë se plani 2023 ose në vlerë 19,914 mijë lekë, dhe në masën 11% ose 19,205 mijë lekë më shumë se i pritshmi 2023, të cilat sipas zërave kryesor janë programuar si vijon:

- “Të ardhurat nga shitja” e apartamenteve dhe njësisive të shërbimit janë planifikuar 11,421 mijë lekë më shumë nga plani 2023 dhe 15,726 mijë lekë më shumë se i pritshmi 2023, kjo për shkak se:
  - a. Krahasuar me planin 2023, për vitin 2024, përvenc riplanifikimit të banesave të pashitura gjatë 2023(Vlorë,Has,Tropojë) është planifikuar shitja e banesave të reja që përfundojnë në 2024 (Vlorë, Delvinë).
  - b. Krahasuar me të pritshmin 2023, rritja është më e madhe për shkak të mosrealizimit të shitjeve të planifikuara gjatë 2023. Përveç kësaj në të ardhurat nga shitja e apartamenteve , ndikon shumë vlera e truallit e cila ndryshon nga qyteti në qytet.
- “Të ardhurat nga 4%” janë planifikuar në masën 11,483 mijë lekë më shumë se plani i vitit 2023 dhe 26,763 mijë lekë më shumë se i pritshmi 2023, për të njëjtat arsye si në planin e të ardhurave nga shitja.
- “Të ardhurat nga privatizimet”, janë planifikuar në masën 6,712 mijë lekë më pak se plani i vitit 2023, dhe 25,258 më pak se i pritshmi 2023. Në këtë kategori një peshë të konsiderueshme zë privatizimi i apartamenteve të ish depove të duhan cigares, ku pjesa më e madhe (90 nga 144 janë privatizuar) pra kanë ngelur vetëm 54 apartamente, të cilat kanë paraqitur veshtirësi nga banorët për arsye të ndryshme.
- Të ardhurat nga interesat e kontratave janë planifikuar pothuajse në nivelet e planit dhe të pritshmit të 2023, për shkak se pavaresisht që janë parashikuar shitje gjatë vitit 2024, dhe për rrjedhojë krijim të klientëve të rinj , por njëkohësisht ka dhe perfundim të kontratave të vjetra dhe mbyllje të detyrimit nga klientet ekzistues.
- Të ardhurat nga interesat e depozitave janë dhe interesat bankare të cilat janë planifikuar në masën 49% më shumë se plani i 2023 dhe 22% më shumë se i pritshmi 2023 për shkak të rritjes së normave të interesit të bankave.
- Të ardhurat e tjera janë planifikuar pak a shumë në nivelin e planit dhe të pritshmit të vitit 2023 . Në këtë zë përfshihen të ardhurat nga shitja e biletave të autoparkut, të ardhurat nga gabime të lejuara të viteve paraardhëse, kamatvonesat etj.

#### **B. Planifikimi i Shpenzimeve të Veprimtarisë së EKB-së.**

Në planifikimin e zërave kryesor të shpenzimeve është mbajtur parasysh që të përballohen nevojat më të domosdoshme për funksionimin normal të veprimtarisë së EKB-së për gjatë vitit 2024.

Planifikimi i shpenzimeve është kryer duke u mbështetur kryesisht në ecurinë e shpenzimeve në vite si dhe duke pasur parasysh rritjen e cmimeve dhe te pagave.Konkretisht planifikimi i shpenzimeve për Degët Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të vitit 2024, pasqyrohen si më poshtë:

Në Lekë

| NR. | Emërtimi                                   | PLANI<br>2019     | PLANI<br>2020     | PLANI<br>2021      | PLANI<br>2022      | PLANI 2023         | I PRITSHMI<br>2023 | PLANI 2024         |
|-----|--|-------------------|-------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| 1.  | Tiranë                                     | 5,063,000         | 5,029,000         | 6,099,500          | 5,997,000          | 8,227,300          | 7,934,379          | 9,592,000          |
| 2.  | Fier                                       | 3,465,100         | 3,353,000         | 3,258,300          | 3,269,000          | 4,419,750          | 4,260,614          | 4,802,900          |
| 3.  | Durrës                                     | 4,232,000         | 4,948,000         | 4,977,700          | 4,973,000          | 6,114,500          | 5,773,533          | 6,450,100          |
| 4.  | Berat                                      | 2,459,600         | 2,371,000         | 2,378,200          | 2,396,000          | 3,068,900          | 2,904,905          | 3,307,500          |
| 5.  | Korçë                                      | 3,445,500         | 3,353,000         | 3,351,100          | 3,325,000          | 4,571,560          | 4,361,765          | 4,687,300          |
| 6.  | Gjirokastrë                                | 3,093,300         | 2,596,000         | 3,026,900          | 3,040,000          | 4,055,660          | 3,818,057          | 4,691,800          |
| 7.  | Shkodër                                    | 3,274,400         | 3,214,000         | 3,252,900          | 3,414,000          | 4,649,640          | 3,818,729          | 4,977,200          |
| 8.  | Elbasan                                    | 3,443,400         | 3,442,000         | 3,497,800          | 3,475,000          | 4,772,090          | 4,232,893          | 4,751,200          |
| 9.  | Vlorë                                      | 3,491,100         | 3,403,000         | 3,387,100          | 3,387,000          | 4,475,850          | 4,366,996          | 4,852,700          |
| 10. | Kukës                                      | 2,139,400         | 2,130,000         | 2,135,100          | 2,461,000          | 3,261,500          | 2,993,353          | 3,386,500          |
| 11. | Dibër                                      | 2,347,700         | 2,355,000         | 2,386,200          | 2,295,000          | 3,052,750          | 2,954,730          | 3,310,600          |
| 12. | Lezhë                                      | 3,321,500         | 3,543,000         | 2,431,200          | 2,711,000          | 3,261,900          | 3,167,587          | 3,486,200          |
| 13. | Dr.Përgjithshme                            | 58,400,000        | 58,163,000        | 60,218,000         | 64,173,000         | 76,470,600         | 73,827,459         | 77,704,000         |
|     | <b>TOTALI</b>                              | <b>98,176,000</b> | <b>97,900,000</b> | <b>100,400,000</b> | <b>104,916,000</b> | <b>130,402,000</b> | <b>124,415,000</b> | <b>136,000,000</b> |
|     | Parashikim për rritjen e pagave gjate 2024 |                   |                   |                    |                    |                    |                    | 10,694,000         |
|     | <b>TOTALI</b>                              |                   |                   |                    |                    |                    |                    | <b>146,694,000</b> |

Më hollësisht programimi i shpenzimeve të veprimtarisë sipas zërave kryesor të tyre për vitin 2024, krahasuar me planet e katër viteve paraardhëse, dhe të pritshmin 2023 paraqitet si më poshtë:

Në Lekë

| NR. | ZËRAT KRYESOR TË SHPENZIMEVE      | PLANI 2019        | PLANI 2020        | PLANI 2021         | PLANI 2022         | PLANI 2023         | I PRITISHMI 2023   | PLANI 2024         | ritje pagash      | Plani 2024 me rritje pagash |
|-----|-----------------------------------|-------------------|-------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|-------------------|-----------------------------|
| 1.  | Shpenzime administrative          | 2,335,000         | 2 174 000         | 2 225 000          | 2,277,400          | 2,600,000          | 2,136,090          | 3,523,800          |                   | 3,523,800                   |
| 2.  | Shpenzime Energji-Ujë             | 1 583 000         | 1 459 300         | 1 306 000          | 1,385,500          | 1,456,500          | 1,128,096          | 1,592,600          |                   | 1,592,600                   |
| 3.  | Shpenzime Udhëtime-Dieta          | 2 092 000         | 2 070 000         | 2 116 000          | 2,205,000          | 2,209,840          | 1,404,978          | 2,019,600          |                   | 2,019,600                   |
| 4.  | Shpenz Postare-Telefonike         | 1 150 000         | 1 132 000         | 1 120 400          | 1,189,600          | 1,140,000          | 800,000            | 900,000            |                   | 900,000                     |
| 5.  | Komisione Bankare                 | 152 100           | 160 400           | 183 400            | 235,000            | 293,000            | 268,585            | 293,600            |                   | 293,600                     |
| 6.  | Pagat e Punonjësve                | 63 730 600        | 63 445 200        | 65 267 800         | <b>68,476,000</b>  | <b>89,026,430</b>  | 87,589,645         | 90,843,400         | 9,085,000         | 99,928,400                  |
| 7.  | Kontributet Sig. Shoqërore        | 10 684 100        | 10 597 600        | 10 899 800         | <b>11,357,000</b>  | <b>15,317,360</b>  | 14,358,000         | 15,576,800         | 1,518,000         | 17,094,800                  |
| 8.  | Shpenzime Tatim Taksa             | 397 300           | 359 500           | 957 400            | 941,300            | 870,800            | 919,030            | 1,168,800          |                   | 1,168,800                   |
| 9.  | Shpenzime Pritjeje                | 50 000            | 50 000            | 80 000             | 90,000             | 100,000            | 100,000            | 100,000            |                   | 100,000                     |
| 10. | Shpenzime rojeve autopark         | 2 200 000         | 2 100 000         | 2 100 000          | <b>2,205,000</b>   | <b>2,174,400</b>   | 2,524,100          | 2,525,100          |                   | 2,525,100                   |
| 11. | Shpenzime Eksperti Kontabël       | 1 200 000         | 1 400 000         | 1 400 000          | 1,400,000          | 1,400,000          | 1,442,000          | 1,500,000          |                   | 1,500,000                   |
| 12. | Honorare Këshilli Drejtues        | 1 800 000         | 2 100 000         | 2 100 000          | <b>2,205,000</b>   | <b>2,113,500</b>   | 3,222,000          | 3,222,000          |                   | 3,222,000                   |
| 13. | Trajnime e Seminare               | 280 000           | 280 000           | 120 000            | 120,000            | 120,000            | <b>200,000</b>     | <b>200,000</b>     |                   | 200,000                     |
| 14. | Penalite e Gjoha                  | 1 750 000         | 2 100 000         | 800 000            | 800,000            | 100,000            |                    | 100,000            |                   | 100,000                     |
| 15. | Shpenzime Riparime                | 850 000           | 1 000 000         | 1 650 000          | 1,200,000          | 1,480,000          | 1,086,200          | <b>2,250,000</b>   |                   | 2,250,000                   |
| 16. | Mirëmbajtje e programit Alpha, të | 450 000           | 240,000           | 300 000            | 400,000            | 200,000            | -                  | 200,000            |                   | 200,000                     |
| 17. | Shpenzime e Qera zyresh           | 707 000           | 707 000           | 1 095 100          | 1,232,100          | 1,357,100          | 1,336,680          | 1,477,200          |                   | 1,477,200                   |
| 18. | Shpenzime Amortizimi              | 3 816 250         | 3 991 600         | 3 748 200          | 3,850,100          | 3,862,030          | 2,236,500          | 2,936,500          |                   | 2,936,500                   |
| 19. | Shpenzime të tjera                | 761 500           | 859 000           | 1 955 200          | 1,362,300          | 1,761,000          | 1,570,250          | 2,831,500          |                   | 2,831,500                   |
| 20. | Shpenzime 1% të përnd             | 637 150           | 634 400           | 652 700            | <b>684,700</b>     | <b>890,040</b>     | 850,510            | 897,100            | 91,000            | 988,100                     |
| 21. | Reklamime TV - dyqanet            | 400 000           | 240 000           | 120 000            | 100,000            | 50,000             | -                  | 50,000             |                   | 50,000                      |
| 22. | Shpenzime antarësimi housing      | 400 000           | 400 000           | 400 000            | 400,000            | 400,000            | 400,000            | 400,000            |                   | 400,000                     |
| 23. | Zbritje akorduar klientëve        |                   |                   |                    |                    | 680,000            | 642,336            | 592,000            |                   | 592,000                     |
| 24. | Shpenzime hapje të gjyqeve        | 350 000           | 2 100 000         | 800 000            | 800,000            | 800,000            | 200,000            | 800,000            |                   | 800,000                     |
|     | <b>SHUMA</b>                      | <b>98 176 000</b> | <b>97 900 000</b> | <b>100,400,000</b> | <b>104,916,000</b> | <b>130,402,000</b> | <b>124,415,000</b> | <b>136,000,000</b> | <b>10,694,000</b> | <b>146,694,000</b>          |

Siç del nga tabela më sipër, shpenzimet e veprimtarisë për vitin 2024 janë programuar më tepër 5,598 mijë lekë krahasuar me planin e vitit 2023, për shkak të planifikimit të disa shtesave në shpenzimet administrative dhe shpenzime të tjera, pasi është planifikuar lyerja dhe përmirësimi i sistemit të ndricimit, një fond për ekspert të jashtëm për hartimin e planit strategjik, blerje programit Office 365 për 70 PC, një shtim në fondin e pagave për shkak të rritjes me një vit të vjetërsisë së punonjësve.

Krahasuar me të pritshmin 2023, është programuar një rritje prej 11,535 mijë lekë, kjo për arsyet që renditëm më sipër, por kemi një programim më të lartë se i pritshmi 2023 për fondin i pagave dhe sigurimeve shëndetësore pasi planifikimi është bërë për strukturën e plotë organike, kurse në fakt gjatë vitit 2023 kemi pasur vende vakante për arsye të ndryshme dhe të pa zëvendësuar, pra kemi pasur kursim në këto zëra. Gjithashtu kemi pasur kursim dhe në zëra të tjerë shpenzimesh, që kanë qene të planifikuara për 2023 por të porealizuara. Për vitin 2024, nëse do ketë rritje pagash për administratën shtetërore, kemi planifikuar një fond shtese për pagat dhe sigurimet shoqërore në nivelin rreth 10% të fondit ekzistues

Mbështetur në treguesit e programuar të të ardhurave dhe shpenzimeve të veprimtarisë, rezultati financiar i planifikuar për çdo Degë Rajonale të EKB-së dhe për Drejtorinë e Përgjithshme paraqiten si vijon;

**REZULTATI FINANCIAR SIPAS DEGEVE 2024**

|    |               |                    |                    | Lekë              |
|----|---------------|--------------------|--------------------|-------------------|
| Nr | Emertimi      | Te ardhura         | Shpenzime          | Rezultati         |
| 1  | TIRANE        | 24,173,400         | 9,592,000          | 14,581,400        |
| 2  | FIER          | 5,292,400          | 4,802,900          | 489,500           |
| 3  | DURRES        | 52,559,000         | 6,450,100          | 46,108,900        |
| 4  | BERAT         | 1,722,500          | 3,307,500          | -1,585,000        |
| 5  | KORCE         | 8,031,800          | 4,687,300          | 3,344,500         |
| 6  | GJIROKASTER   | 5,944,700          | 4,691,800          | 1,252,900         |
| 7  | SHKODER       | 7,273,300          | 4,977,200          | 2,296,100         |
| 8  | ELBASAN       | 7,185,500          | 4,751,200          | 2,434,300         |
| 9  | VLORE         | 33,345,400         | 4,852,700          | 28,492,700        |
| 10 | KUKES         | 22,264,000         | 3,386,500          | 18,877,500        |
| 11 | DIBER         | 11,505,000         | 3,310,600          | 8,194,400         |
| 12 | LEZHE         | 2,989,000          | 3,486,200          | -497,200          |
| 13 | Dr. PERGJITH  | 17,300,000         | 77,704,000         | -60,404,000       |
|    | <b>TOTALI</b> | <b>199,586,000</b> | <b>136,000,000</b> | <b>63,586,000</b> |


|  |                                   |                    |                    |                   |
|--|-----------------------------------|--------------------|--------------------|-------------------|
|  | <b>Efekti i rritjes se pagave</b> |                    | 10,694,000         |                   |
|  | <b>Rezultati me rritje pagash</b> | <b>199,586,000</b> | <b>146,694,000</b> | <b>52,892,000</b> |

Rezultati financiar për vitin 2024 është parashikuar në vlerën 63,586 mijë lekë, nga 67,930 mijë lekë lekë që ishte planifikuar në vitin 2023, me ulje në masën 5%, kjo për shkak të rritjes së shpenzimeve në një masë pak më të larte se rritja e të ardhurave. Për vitin 2024 me humbje është planifikuar Dega Berat e cila të ardhurat për këtë vit, i siguron vetëm nga interesat pasi nuk ka në dispozicion apartamente për të shitur ose privatizuar. Në fakt, Dega Rajonale Berat, ka 15 apartamente të trashëguara nga ish-Komunale Banesa dhe të përfunduara nga EKB, por janë të palegalizuara për shkak dokumentacionit jo të plotë dhe të ekspertizës teknike për të cilat janë planifikuar fondet e nevojshme për tu kryer gjatë vitit 2024. Për shkak të procedurave të cilat zgjasin nuk janë parashikuar për tu shitur gjatë 2024. Gjithashtu me humbje është planifikuar Dega Lezhë pasi nuk ka apartamente në dispozicion për të shitur, përveç dy apartamenteve për privatizim, të cilat për shkak të vjetërsisë dhe amortizimit, sigurojnë të ardhura minimale.

Ecuria e Treguesve financiarë në 5 vitet e fundit paraqitet si vijon;

000Lekë

| Emërtimi                   | Plani 2020    | Fakti 2020    | Plani 2021    | Fakti 2021    | Plani 2022    | Fakti 2022     | Plani 2023    | I pritshmi 2023 | Plani 2024    |
|----------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|----------------|---------------|-----------------|---------------|
| Të ardhurat                | 159,853       | 139,362       | 155,334       | 148,752       | 163,087       | 218,077        | 179,672       | 180,380         | 199,586       |
| Shpenzimet                 | 102,693       | 92,912        | 100,400       | 94,238        | 104,916       | 92,314         | 111,742       | 124,415         | 136,000       |
| <b>Rezultati Financiar</b> | <b>57,160</b> | <b>46,450</b> | <b>54,934</b> | <b>54,513</b> | <b>58,171</b> | <b>125,762</b> | <b>67,930</b> | <b>55,965</b>   | <b>63,586</b> |



Krahasimi i treguesve është bërë pa marrë parasysh fondin shtesë për rritjen e mundshme të pagave gjatë vitit 2024.

## Rezervat dhe Risqet

1. Në programin ekonomik dhe financiar të vitit 2024, janë planifikuar të ardhura nga lidhja e rreth lidhja e rreth 362 kontrata të reja me fondet e veta të EKB-së, nga të cilat, Vlorë(1+2) 75 ap., Vlorë(3+4) 75 ap, Has 35, Tropojë 25, Shkodër 10, Dibër 26, Gjirokastra 29 dhe Lezhë 2, dhe me fonde te buxhetit te shtetit, Tirana 33 dhe Durrësi 47, Korca 4.

Mbështetur në analizën e kostos së ndërtimit të banesave, analizës së çmimeve të shitjes të apartamenteve dhe gjëndjes ekonomike të banorëve të bashkive, rezulton se propabiliteti dhe impakti i riskut vlerësohet i ulët dhe nuk ka efekt financiar në mos realizimin e të ardhurave, duke marrë parasysh shitjen e menjëhershme në banesat e përfunduara, Gramsh, Maliq dhe Kukës (përfunduar rastin e 2 banesave të para të Vlorës shitja e së cilës u pengua për shkaqe të paparashikuara). Kurse dukë marrë shkas nga realizimi dhe ecuria e investimeve në dy vitet e fundit, mospërfundimi sipas parashikimeve i banesave të reja, impakton një risk të lartë, pasi mos përfundimi në kohë sjell edhe mosrealizimin e shitjeve dhe për pasojë mosrealizimin e të ardhurave. Kjo duke marrë shkas nga mosrealizimi i planit të shitjes gjatë vitit 2023 për shkak të mospërfundimit të banesave në Has, Tropojë dhe Burrel.

2. Plotësimi i planit të të ardhurave nga shitja e 32 njësi të shërbimit dhe 52 garazheve të ndërtuara me fondet e veta të EKB-së, nëpërmjet ankandeve të njësi të shërbimit dhe garazheve, nga të cilat: 3 njësi shërbimi në Fier, 1 njësi shërbimi (Librazhd), 12 garazhe në Gramsh, 3 garazhe në Korçë, 8 garazhe në Maliq, 11 garazhe dhe 9 njësi në Vlorë, 7 njësi shërbimi në Tropojë, 9 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Has, 9 garazhe dhe 6 njësi shërbimi në Burrel.

mund të reduktohet për mungesë ofertash nga subjektet e interesuara, dhe paraqet risk duke parë ecurinë e shitjeve gjatë dy viteve të fundit.

**3.** Planifikimi i të ardhurave nga 4% të cilat janë të lidhura me shitjen e apartamenteve si dhe nga privatizimet me VKM, paraqet risk për mos realizim për të njëjtat shkaqe si në realizimin e të ardhurave nga shitja.

**4.** të ardhurat nga interesat e kontratave dhe të ardhurat e tjera, parashikojmë të plotësojmë ritmikisht planin sipas programimit dhe nuk mendojmë të kemi risk ose mos realizime, kjo vërtetohet edhe mbi bazën e rezultateve të arritura në vitet e kaluara, që këto zëra kryesor kanë dhënë të ardhura suplementare mbi planin vjetor.

**5.** Planifikimi i arkëtimeve nga shitja, është bërë mbi bazën e detyrimeve që kanë klientët për pagesat e kësteve mujore dhe vjetore, si dhe është mbajtur në konsideratë ndjekja ritmike e arkëtimeve nga kështet e planifikuara të kredive dhe të interesave të kontratave, duke zbatuar procedurat e Manualit “Politikave dhe Procedurat e Menaxhimit të Debitorëve”.

Për këtë do kryejmë analizat përkatëse në bashkëpunim me degët do të marrim masat përkatëse për debitorët duke zbatuar kërkesat e manualit mbi menaxhimin e debitorëve, duke u dhënë mundësitë e lidhjes së akt-marrëveshjeve përkatëse, ose për debitorët që nuk ofrojnë mundësi pagese do të ndërmerren hapat ligjore nëpërmjet proceseve gjyqësore. Nisur nga eksperiencat e mëparëshme, gjatë vitit pakësohen një numër debitorësh më të lartë se sa krijohen të rinj gjatë vitit dhe gjendja e detyrimeve të debitorëve vjen në ulje nga viti në vit, dhe do të përpiqemi të minimizojmë riskun për realizimin e planit të arkëtimeve. Realizimi i arkëtimeve sidomos në zërin arkëtime nga 4% dhe 10%, paraqiten me risk për arsyet që përmendëm më sipër.

**6.** Programimi i investimeve ndërtimore për vitin 2024 është në shumën 1,128 milion lekë për ndërtimin e 7 banesave të reja me kosto të ulët nga të cilat 2 banesa (Shijak, Tropojë) është miratuar nga Këshilli Drejtues dhe 5 banesa të tjera (Shkodër, Lushnje, Peshkopi, Korçë dhe Burrel) që mund të miratohen gjatë vitit në vazhdim pasi të kryehen analizat e riskut .

Informojmë se për çdo banesë në ndërtim është bërë më parë analiza teknike e ndërtimit dhe e riskut dhe më pas janë miratuar me vendim të Këshillit Drejtues, dhe nuk parashikohet risk lidhur me fondet e financimit të cilat janë nga burimet e veta të EKB-së. Për këtë më parë se të programohet nga Drejtoria Ekonomike është bërë parashikimi i Cash Floë-t për vitin 2024, ku rezulton se niveli i gjendjes së arkëtimeve dhe fondeve të depozitave mund të përballojnë financimin e investimeve në proces dhe të shpenzimeve të aktivitetit të EKB-së për vitin 2024 dhe 2025, por në fund të vitit 2025 parashikojmë që të mbeten likuiditete të lira dhe në depozitat bankare rreth **187miljon lekë**, i cili është parashikuar në kushtet e realizimit të shitjeve sidomos në banesat e reja, dhe arkëtimin e 4% dhe 10% në mënyrë të menjëhershme.

Më konkretisht Parashikimi i Cash Floë-t për vitet 2024-2026 paraqitet si vijon;


## Parashikimi i Cash Floë-t për vitin 2024-2026

000 lekë

000/Lekë

| Nr         | Emertimi  | Parashikimi<br>Cash Floë<br>Dhjet 2023 | Parashikimi<br>Cash Floë<br>2024 | Parashikimi<br>Cash Floë<br>2025 | Parashikimi<br>Cash Floë<br>2026 |
|------------|---|--|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|
| <b>I</b>   | <b>Gjendje likuiditete fillim</b>               | <b>730,000</b>                         | <b>662,181</b>                   | <b>498,475</b>                   | <b>187,625</b>                   |
| a-         | Llogari rrjedhese                               | 180,000                                | 102,181                          | 48,475                           | 87,625                           |
| b-         | Depozite  | 510,000                                | 560,000                          | 450,000                          | 100,000                          |
|            |   |  |                                  |                                  |                                  |
| <b>II</b>  | <b>ARKETIMET</b>                                | <b>32,600</b>                          | <b>413,895</b>                   | <b>451,000</b>                   | <b>396,000</b>                   |
| 1          | Arkëtime nga këstet (princip+interes)           | 30,000                                 | 212,736                          | 216,000                          | 218,000                          |
| 2          | Arkëtime te menjehershme (10%, 4%, etj)         |  | 165,632                          | 180,000                          | 150,000                          |
| 3          | arkëtime nga shitja e garazheve+ njesi sherbimi |  | 18,283                           | 40,000                           | 20,000                           |
| 4          | Arkëtime te tjera                               | 1,100                                  | 3,444                            | 5,000                            | 2,000                            |
| 5          | Interesat depozitave                            | 1,500                                  | 13,800                           | 10,000                           | 6,000                            |
|            | <b>Shuma</b>                                    | <b>32,600</b>                          | <b>413,895</b>                   | <b>451,000</b>                   | <b>396,000</b>                   |
| <b>III</b> | <b>PAGESAT</b>                                  | <b>100,419</b>                         | <b>577,601</b>                   | <b>761,851</b>                   | <b>194,403</b>                   |
| <b>A</b>   | <b>Investime banesa</b>                         |  |                                  |                                  |                                  |
| 1          | HAS   | 3,213                                  | 9,846                            | 0                                | 0                                |
| 2          | KUKES   | 0                                      | 600                              | 0                                | 0                                |
| 3          | VLORA 1   | 0                                      | 800                              | 0                                | 0                                |
| 4          | VLORA 2   | 36,546                                 | 39,501                           | 0                                | 0                                |
| 5          | TROPOJA   | 0                                      | 18,810                           | 0                                | 0                                |
| 6          | BURREL  | 0                                      | 14,526                           | 0                                | 0                                |
| 7          | SHIJAK  | 0                                      | 50,612                           | 54,378                           | 0                                |
| 8          | DELVINE   | 10,132                                 | 33,011                           | 0                                | 0                                |
| 9          | ROSKOVEC  | 20,228                                 | 62,119                           | 0                                | 0                                |
| 10         | SHKODER   |  | 30,367                           | 84,513                           | 5,975                            |
| 11         | LUSHNJE   |  | 30,278                           | 127,410                          | 7,030                            |

|          |   |                |                 |                 |                |
|----------|---|----------------|-----------------|-----------------|----------------|
| 12       | TROPOJA2                                      |                | 30,367          | 84,513          | 5,975          |
| 13       | PESHKOPI                                      |                | 30,367          | 84,513          | 5,975          |
| 14       | BURRELI 2                                     |                | 30,367          | 84,513          | 5,975          |
| 15       | KORCE   |                | 30,367          | 84,513          | 5,975          |
|          | <b>Shuma</b>                                  | <b>70,119</b>  | <b>411,941</b>  | <b>604,351</b>  | <b>36,903</b>  |
| <b>B</b> | <b>Investime të tjera</b>                     |                |                 |                 |                |
| 1        | Blerje paisje elektronike                     | 200            | 850             | 1,000           | 1,000          |
| 2        | Blerje programi                               |                | 10,000          |                 |                |
| 3        | Blerje orendi zyresh                          | 100            | 410             | 500             | 500            |
|          | <b>Shuma</b>                                  | <b>300</b>     | <b>11,260</b>   | <b>1,500</b>    | <b>1,500</b>   |
| <b>C</b> | <b>Shpenzime të tjera</b>                     |                |                 |                 |                |
| 1        | Shpenzime operative                           | 30,000         | 142,400         | 144,000         | 144,000        |
|          | <i>Tatim Fitimi</i>                           |                | 12,000          | 12,000          | 12,000         |
|          | <b>Shuma</b>                                  | <b>30,000</b>  | <b>154,400</b>  | <b>156,000</b>  | <b>156,000</b> |
| <b>D</b> | <b><i>Gjendja e likuiditeteve ne fund</i></b> | <b>662,181</b> | <b>498,475</b>  | <b>187,625</b>  | <b>389,222</b> |
| a-       | <b>Llogari rrjedhese</b>                      | 102,181        | 48,475          | 87,625          | 89,222         |
| b-       | <b>Depozite</b>                               | 560,000        | 450,000         | 100,000         | 300,000        |
| 2        | Totali i Hyrjeve                              | 32,600         | 413,895         | 451,000         | 396,000        |
| 3        | Totali i Daljeve                              | 100,419        | 577,601         | 761,851         | 194,403        |
|          | <b>Diferenca</b>                              | <b>-67,819</b> | <b>-163,706</b> | <b>-310,851</b> | <b>201,598</b> |



### **III. PLANIFIKIMI DHE DETAJIMI I PLANIT TË INVESTIMEVE NDËRTIMORE PËR VITIN 2024.**

Për vitin 2024, parashikimi i investimeve është hartuar vetëm me ato Bashki që kanë ofruar sheshe ndërtimi dhe janë angazhuar të bashkëpunojnë duke siguruar sheshe ndërtimi të cilat kanë leverdisshmëri. Aktualisht EKB ka siguruar sheshe ndërtimi nga Bashkitë Shkoder, Lushnje, Peshkopi, Burrel, Tropojë, Korçë, Berat etj. dhe po vazhdohet me ndërtimin e banesave në qytetet Vlorë II, Has, Burrel, Delvinë dhe Roskovec.

Në qytetin e Shijakut për të cilin është miratuar në Këshillin Drejtues, ndërtimi i banesë 6 kate me parkim nëntokë dhe kemi marr lejen zhvillimore po hasim pengese pasi kjo bashki akoma nuk na ka paisur me leje ndertimi. Nga ana jone per objektet e reja qe parashikohen per vitin 2024 po vijon puna për realizimin e të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor të nevojshëm për miratimin dhe nisjen e investimeve.

Në fushën e investimeve, objektivi i vitit 2024 do të jetë:

- a. Përfundimi i banesave të nisur nga viti 2021 dhe 2022, në qytetin e Vlorës II, Has;Tropojë; Delvinë; Burrel;
- b. Vazhdimi i punimeve në banesën Roskovec;
- c. Fillimi i ndërtimit të banesës për të pastrehët në qytetin e Shijakut; Lushnje; Tropoja II;Burreli II; Shkodër;

- d. Zgjerimin e bashkëpunimit të EKB-së me organet e vetëqeverisjes vendore, për regjistrimin e shesheve të ndërtimit për ndërtimin e banesave me kosto të ulët për strehimin e familjeve të pastreha sikurse është kërkuar për Shkodrën, Peshkopin, Korçë, Lushnje, për të cilat ka patur disa takime/komunikime dhe korrespondenca ndërinstitucionale për keto projekte.
- e. Parashikimi dhe Detajimi i Planit të Investimeve Ndërtimore vetëm për shpenzimet e kontratave të sipërmarrjes, mbikëqyrjes, kolaudimit, etj.

**Tabela 1 – Investimet e reja**

| <b>Nr.</b> | <b>Emertimi objektit</b>  | <b>Vlera e investimit gjate 2024</b> |
|------------|---|--------------------------------------|
| <b>A</b>   | <b>Investime të vitit 2024</b>  | <b>768,990,000</b>                   |
| <b>1</b>   | <b>Objekti, Tropoja 2 6kat</b>  | <b>120,854,500</b>                   |
| *          | Ndërtim për banesën në Tropojë, nr. 2   | 112,700,000                          |
| *          | Mbikqyrje Punimesh banesa në Tropojë, nr. 2   | 1,380,000                            |
